



AKT THEMELIMI
“UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI” (UMVSH) SH.P.K.
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)

Sot, më datë 16.02.2015, te nenshkruarit:

1. **Z. Luan BETAJ**, shtetas shqiptar, lindur me 24.02.1953, lindur ne Tepelene dhe banues ne adresen Rr. “Abdyl Frasheri”, pall. 11, shk. 1, ap.2, Tirane, i identifikuar me leternjoftimin numer 028351350, madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar;
2. **Z. Ilias Foutsis**, shtetas grek, lindur ne Messinia dhe banues ne Athine ne Rr. “Amalias 38”, Syntagma, 105 58 Athine, Greqi, i datelindjes 09.09.1948, mbajtes i pasaportes me nr. Al 1480781.
3. **Z. Agim HUSHI**, shtetas shqiptar, lindur me 21.05.1964, lindur ne Durres dhe banues ne Viene ne adresen Rr. “Keinergasse”, nr. 4/12, 1030, Viena, Austri, i identifikuar me pashaporten numer N(026421), madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar.
4. **Z. Rudenc RUKA**, shtetas shqiptar, lindur me 21.02.1979, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. “Mihal Grameno”, pall. 9, shk.1, ap.8, Tirane, i identifikuar me leternjoftimin numer 024395167, madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare” te ndryshuar dhe ligjit nr.9723, date 3.5.2007, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI” (UMVSH) SH.P.K., “VIENNA MUSIC UNIVERSITY OF ALBANIA” (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse dhe i bashkangjitet këtij Akti Themelimi.

Neni 1

Public Notar

Emri i Shoqërisë do të jetë "UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI" (UMVSH) SH.P.K., dhe në gjuhën e huaj "VIENNA MUSIC UNIVERSITY OF ALBANIA"

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: "UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI" (UMVSH) Sh.p.k, Rr. "Komuna Parisit" Vila nr. 2 (ish Universiteti i New York-ut), Tirane, Shqipëri.

Shoqëria ka të drejtë të hapë dege apo filiale, zyra perfaqesimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të vendit, gjatë aktivitetit të saj.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar në kohë, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit (QKR).


Neni 4

Objekti i Shoqërisë është si vijon:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI" (UMVSH) "VIENNA MUSIC UNIVERSITY OF ALBANIA" do të shtrihet në fushën e zhvillimit të aktivitetit të mesimdhënies dhe të programet e zhvillimit kulturor. Konkretisht, do të jetë ushtrimi i aktivitetit të mesimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit si dhe ushtrimi i cdo veprimtarie tjetër, që lidhet me arsimin, artin dhe kulturën. Cdo aktivitet do të kryehet mbi bazën e licenses perkatëse të marra nga organet kompetente dhe në përputhje me legjilacionin shqiptar në atë fushë. Shoqëria do të organizojë dhe struktura të arsimit parauniversitar si dhe ngritjen dhe funksionimin e një shkolle të lartë jo publike të nivelit universitar në deget e muzikës dhe artit muzikor. Hapja dhe menaxhimi i shkollave verore. Të organizojë programet e edukimit profesional, seminare, kurse për mesimin e



Rudolf Bora








aktivitet dhe biznes lidhur me ofrimin e studimeve te larta te nivelit pasuniversitar per pergatitjen e specialisteve te afte per te kryer veprimtari kerkimore shkencore, me kualifikim shkencor pasuniversitar, duke organizuar kurse te specializimit dhe kualifikimit, dhe ne veçanti kurse te specializimit ne fushat muzikes dhe te artit. Botimi dhe tregtimi i librave ne fushen akademike me qellim perdorimin si baze literature ne universitet dhe per promovimin e degeve te artit muzikor ne Shqiperi. Shoqeria mund te kryeje dhe çdo aktivitet apo veprimtari tjeter qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria per zhvillimin e aktiviteteve te mesiperme si dhe sa here te lind nevoja duhet te mbeshtetet ne punen e profesionisteve te njohur nga ligji dhe personave qe kane te drejte te ushtrojne rast pas rasti aktivitetin perkates nese ai eshte objekt licensimi.

Shoqeria mundet, brenda kujifve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, te zhvilloje te gjitha aktivitetet tregtare te nevojshme per arritjen e qellimit per te cilin eshte krijuar; mund te kryeje levizje bankare prane cdo banke ose institucioneve te tjera financiare te njohura nga ligji (veprime te tilla si: te perfitoje financime, kredi, me ose pa garanci; te kete llogari rrjedhese ose llogari te ndryshme bankare); ne vecanti shoqeria mundet: te marre me qira, edhe financiare, te jape me qira, duke perjashtuar ate financiare, te mira materiale dhe te kosumit, pasuri te tundshme e te patundshme; te blejne aksione apo interesa ne shoqeri te tjera qe kane te njejtin qellim ose qellime te perbashketa, ti administrojne e ti likuidojne. Perjashtohen nga ky objekt te gjitha veprimtarite financiare te cilat me ligj jane te rezervuara ekskluzivisht per bankat ose institucione te ndryshme financiare. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe eshte brenda ketij objekti veprimtarie dhe brenda kuadrit te normave ligjore ne fuqi.

  *Indre ...* 

Neni 5

Kapitali baze i themelimit te Shoqerise "UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI" (UMVSH) Sh.p.k eshte 1,000,000 (nje million) leke, dhe eshte teresisht kontribut i ortakeve, si me poshte:

Z. Luan BETAJ ka kontribuar 510,000 (peseqind e dhjete mije) leke dhe zoteron nje kuote te barabarte me zoteron 51% te kapitalit,

Z. T. Ilias FOUTSIS ka kontribuar 290,000 (dyqind e nentedhjete mije) leke dhe zoteron nje kuote te barabarte me 29% te kapitalit;

Z. HUSHI, ka kontribuar 100,000 (njeqind mije) leke dhe zoteron nje kuote te barabarte me 10% te kapitalit

Z. Rudenc RUKA, ka kontribuar 100,000 (njeqind mije) leke dhe zoteron nje kuote te barabarte me 10% te kapitalit

Ortaket mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Ortakeve. Detyrimet e ortakeve kundrejt Shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre. Ortaket nuk do te kene asnje pergjegjesi tjetere per detyrime te tjera te Shoqerise.

Neni 6

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratoret



Mudhe Mudhe 

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve si dhe te Administratorit te Shoqerise jane te parashikuara ne statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratoret e Shoqerise.

Neni 8




Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj Shoqerise dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj Shoqerise nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'registrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

  *Andic Mba* 

Neni 11

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakeve të Shoqërisë.


Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, në prani të përkthyesit të gjuhës angleze Z. Marsel Llupa për ortakun e huaj .


Përsa është shprehur në këtë Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjit nr.9723. datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

ORTAKET E SHOQËRISE

"Universiteti Muzikor i Vjenës në Shqipëri" SH.P.K.




Z. Luan BETAJ



Z. Agim HUSHI




Z. Ilias FOUTSIS



Z. Rudenc RUKA

RUDENC RUKA

Rudenc Ruka





VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Tirane, me date 16 Shkurt 2015 (dymije e pesembedhjete), para meje JULIAN ZHELEGU, noter prane Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, u paraqiten:

Z. Luan Betaj, shtetas shqiptar, lindur me 24.02.1953, ne Tepelen dhe banues ne adresen Rr. "Abdyl Frasheri", Pall.11, Shk.1, Ap.2, Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 028351350 dhe nr. Personal F30224101K, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Z. Ilias Foutsis, shtetas grek, i biri i Sotir, lindur me 09.09.1948, Messinia dhe banues ne Athine, Greqi, mbajtes i pasaportes me nr. A1 1480781, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Z. Agim HUSHI, shtetas shqiptar, lindur me 21.05.1964, lindur ne Kavaje, Durres dhe banues ne Viene, ne adresen Rr. "Keinergasse", nr. 4/12, 1030, Viena, Austri, i identifikuar me pasaportes me nr. N 1026421, madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar.

Z. Rudenc RUKA, shtetas Austriak, lindur me 21.02.1979, banues ne Tirane ne adresen Rr. "Mihal Grameno", Pall. 9, Shk. 1, Ap.8, Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 024395167 dhe nr. Personal H90221054K, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Te cilet deklaruan se ne prani te perkthyesit te gjuhes Angleze Z. Marsel Llupa, kane nenshkruar me vullnet te lire e te plote dokumentin bashkangjitur ketij vertetimi, Akt Themelimi i shoqerise "UNIVERSITETI MUZIKOR I VJENES NE SHQIPERI" SH.P.K (U.M.V.SH), e une noteri vertetoj nenshkrimin e tyre rregullisht sipas ligjit.

NOTER
JULIAN ZHELEGU